



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 03 korrik 2020
Kodi i ZRRE-së: V_1267_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Neni 15, Nenin 26, Neni 28 paragrafi 2, nënparagrafi 2.1, Nenin 30, Nenin 32 paragrafin 2 nënparagrafi 2.1, Nenin 34 dhe Nenin 38 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 6 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085)
- Dispozitat e Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla Nr.07/2017);
- Marrëveshjes për Blerje të Energjisë Elektrike (MBA) të lidhur mes ndërmarrjes "Hidroenergji" SH.P.K dhe Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) SH.A, si dhe
- Aplikacionin për Licencim të Aktivitetit të Prodhimit të Energjisë Elektrike të dorëzuar në Rregullator me datë 20.12.2018 nga ndërmarrja "Hidroenergji" SH.P.K, adresa Dëshmorët e Kombit, p.n. Ferizaj, (lokacionit i hidrocentralit: Sllatinë, komuna e Kaçanikut), Republika e Kosovës.
- Vendimin për Leje Mjedisore, të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (MEA), për ndërmarrjen "Hidroenergji" Sh.P.K. Ferizaj, Hidrocentrali "Lepenci 3", me Nr. të protokollit 1948-4/19, të datës 30.06.2020.

në seancën e mbajtur me datë 03 korrik 2020, nxori këtë:

VENDIM

- I. LËSHOHET** Licencë për prodhim të energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme të energjisë nga Hidrocentrali "Lepenci 3" me kapacitet 9.98 MW, ndërmarrjes "Hidroenergji" SH.P.K, me numër licence ZRRE/Li_63/20, për periudhën katërdhjetë (40) vjeçare, nga data 03.07.2020 deri me 02.07.2059.
- II.** Në afatin e Licencës të dhënë në pikën I të këtij Vendimi, është llogaritur edhe periudha prej dymbëdhjetë (12) muajsh i Licencës së përkohëshme të lëshuar nga Rregullatori, me vendimin V_1140_2019 për periudhën nga data 05.06.2019 deri më 04.06.2020.
- III. Obligohet** ndërmarrja të sjell në Rregullator çdo dokument të lëshuar nga institucione të ndryshme për "Hidroenergji" SH.P.K, të cilët mund të kenë ndikim në validitetin dhe periudhën e vlefshmërisë së licencës së lëshuar, si dhe çdo dokument i cili mund të ndryshoj nga ai i sjellë gjatë aplikimit për marrje të licencës.

Arsyetim

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (Rregullatori) me datë 20.12.2018 ka pranuar Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për Licencim të aktivitetit të Prodhimit të energjisë elektrike në Kosovë nga Ndërmarrja "Hidroenergji" SH.P.K., për hidrocentralin (HC) "Lepenci 3", me kapacitet të instaluar prej 9,98 MW, me lokacion në Sllatinë, Komuna e Kaçanikut.
- o Për licencim të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, përveç tjerash kërkohet edhe Leja Mjedisore. "Hidroenergji" SH.P.K. në pamundësi të nxjerrjes së Lejes Mjedisore nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) (tani Ministria e Ekonomisë dhe



Ambientit- MEA), kishte dorëzuar në Rregullator Kërkesën e dorëzuar në MMPH me datë 11.04.2019 për t'u pajisur me Leje Mjedisore nga kjo Ministri.

- o Rregullatori, duke u bazuar në Nenin 5 paragrafin 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, me vendimin V_1140_2019 fillimisht i kishte lëshuar Licencë të përkohshme (me numër licence ZRRE/Li 63/18) ndërmarrjes në fjalë, për periudhën nga data 05.06.2019 deri më 04.06.2020, me kusht që ndërmarrja të sjell në Rregullator Lejen Mjedisore brenda dymbëdhjetë (12) muajsh.
- o Me datë 30 qershor 2020, përfaqësues të ndërmarrjes "Hidroenergji" SHPK kanë dërguar në Rregullator "Vendimin për Leje Mjedisore", të lëshuar nga Ministria përkatëse (Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit), me Nr. të protokollit 1948-4/19, të datës 30.06.2020.
- o Rregullatori ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar sipas udhëzimeve të Rregullatorit, kërkesave të parapara në Aplikacionin për Licencim të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike dhe legjislacionit në fuqi, kështu që pas vlerësimit të aplikacionit dhe dëshmimeve tjera të bashkangjitura aplikacionit të ndërmarrjes "Hidroenergji" SH.P.K, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

IV. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i Rregullatorit:


Arsim Janova, u.d. Kryesues


Besim Sejfiqaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar

Vendimi i dërgohet:

- Ndërmarrjes "Hidroenergji" SH.P.K,
- KOSTT dhe
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji